



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____.____.2021

LËNDA: Kthim përgjigje.

Qendra “R-P”

TIRANË

Z. D.M

I nderuar Z. M!

Duke shprehur konsideratën për veprimtarinë tuaj, në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion ardhur me e-mail, datë 14.01.2021, regjistruar me aktin nr. 4089/2 prot., datë 25.01.2021, referuar nenit 14§2§b të Ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, ju bëjmë me dije si më poshtë vijon:

- *Në lidhje me pyetjen “Sa persona janë punësuar në njësinë e shërbimit ligjor, pranë Gjykatës së Lartë”?*

KLJGJ në përmbushje të përgjegjësisë për mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor, në respektim të parimit qeverisës të efikasitetit, në ushtrim të kompetencave në lidhje me administrimin e sistemit gjyqësor, bazuar në nenin 147/a, pika 1, shkronja “d”¹, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet 89 dhe 94 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar ka filluar procesin për miratimin e rregullave më të detajuara për funksionimin e brendshëm të gjykatave. Për shkak të rëndësisë dhe pozicionit të posaçëm që ka Gjykata e Lartë në sistemin gjyqësor, si dhe nisur nga domosdoshmëria për ta bërë atë sa më efektive jo vetëm duke mbajtur parasysh uljen e numrit të çështjeve të prapambetura por edhe përshtatjen e saj me risitë e kuadrit ligjor të miratuar, është miratuar nga KLJGJ me vendimin nr.643 datë 23.12.2020 “Rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësisë të kategorive të punonjësve të Gjykatës së Lartë”.

Pas miratimit të këtyre rregullave standarde, Këshilli i Gjykatës së Lartë po procedon me përshtatjen e strukturës aktuale sipas rregullave të reja të organizimit të brendshëm, si dhe me plotësimin e vakancave të krijuara në administratë me qëllim kryerjen me efektivitet të funksioneve ligjore. Në nenin 7 të kësaj rregulloreje parashikohet se “1. Njësia e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë, që përbëhet nga këshilltarë ligjorë magjistratë dhe jomagjistratë, është strukturë ndihmëse dhe këshilluese në procesin vendimmarrës të Gjykatës. [...] 3. Numri i

¹ Neni 147/a, pika 1, germa “d”, i Kushtetutës parashikon: “1. Këshilli i Lartë Gjyqësor ushtron funksionet e mëposhtme: ... d) drejton dhe kujdeset për mbarëvajtjen e punës në administratën e gjykatave...”.

përgjithshëm i këshilltarëve ligjorë si dhe rregullat e hollësishme për organizimin, funksionimin dhe ndërveprimin e Njesisë së Shërbimit Ligjor me strukturat e tjera të Gjykatës parashikohen në rregulloren e brendshme të Gjykatës së Lartë.”

Nga informacioni i disponueshëm pranë Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative, i përditësuar me atë të ardhur nga Gjykata e Lartë, pranë Njesisë së Shërbimit Ligjor, aktualisht ushtrojnë veprimtarinë gjithsej 16 nëpunës, nga të cilët 6 janë ndihmës magjistratë dhe 10 janë këshilltarë ligjorë. Në këto shifra janë të përfshirë edhe emërimet bërë së fundmi nga KLGJ të 4 ndihmësmagjistratëve² dhe emërimin e përkohshëm të 4 këshilltarëve ligjorë³ që kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës në shtator të 2020.

- *Në lidhje me pyetjen “A është ngritur struktura Qendrës së Dokumentacionit? Nëse po, sa persona janë punësuar pranë Qendrës”?*

Qendra e Dokumentacionit e parashikuar si strukturë në administratën e Gjykatës së lartë, është strukturë ndihmëse në funksion të gjyqtarëve dhe të Njesisë së Shërbimit Ligjor. Ajo është përgjegjëse, kryesisht për publikimin e vendimeve të Gjykatës së Lartë dhe përgatitjen e analizave, kërkimeve studimore mbi praktikën gjyqësore vendase dhe ndërkombëtare sipas nevojave të Gjykatës. Këshilli i Gjykatës së Lartë po procedon me përshtatjen e strukturës aktuale sipas rregullave të reja të organizimit të brendshëm, si dhe me plotësimin e vakancave të krijuara në administratë me qëllim kryerjen me efektivitet të funksioneve ligjore ndaj dhe vlerësojmë që për më shumë informacion ti drejtoheni kësaj Gjykate.

- *Në lidhje me pyetjen “Në çfarë faze është procedura për emërimin e Kancelarit të përhershëm të Gjykatës së Lartë”?*

Lidhur me këtë pyetje sjellim në vëmendje se Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 90 dhe 97, pika 1 shkronja “a”, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 55 dhe 83 të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, ka miratuar fillimisht Vendimin nr. 424, datë 12.10.2020, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose ndihmës ligjor”.

Miratimi i këtij akti përbën rëndësi për procesin e rekrutimit të kancelarit të kësaj gjykate.

- *Në lidhje me pyetjen e “Cilat janë pengesat e emërimit të gjyqtarëve të tjerë të Gjykatës së Lartë”?*

Funksionalizimi i Gjykatës së Lartë është një ndër e tij, ndaj dhe Këshilli është kujdesur të marrë hapa të matura, duke u konsultuar në vijimësi me partnerët ndërkombëtarë që asistojnë veprimtarinë e Këshillit, në mënyrë që çdo vendimmarrje e tij t'i shërbejë zgjidhjes së situatës së paprecedent të krijuar në këtë gjykatë, duke respektuar parimet kushtetuese në funksion të konsolidimit të shtetit të së drejtës.

Në këtë kuadër, siç dhe jeni në dijeni, janë hartuar një sërë aktesh nënligjore të domosdoshme, të cilat sigurojnë transparencë dhe integritet të procesit, në funksion të përzgjedhjes sipas meritave të kandidatëve për në Gjykatën e Lartë. KLGJ ka punuar me shumë kujdes **për të hartuar një**

² Me vendimet nr. 432, 433, 434 dhe 435, datë 14.10.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor, ka emëruar 4 gjyqtare, si ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë.

³ Me vendimet nr. 611, datë 10.12.2020, nr. 612 datë 10.12.2020, nr. 613, datë 10.12.2020, nr. 614, datë 10.12.2020, nr. 615, datë 10.12.2020, nr. 616, nr. 617, datë 10.12.2020, nr. 618, datë 10.12.2020.

paketë të plotë ligjore, e cila përcakton rregullat dhe kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve, duke siguruar që procesi i përzgjedhjes të zhvillohet në një mënyrë të hapur dhe transparente, dhe që rezultati i çdo procesi të përzgjedhjes (rekrutimi apo promovimi) të jetë i pakompromentueshëm apo i paragjykuar. Janë miratuar në këtë kuadër:

- Vendimin nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”;
- Vendimin nr. 102, datë 05.07.2019, “Mbi kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jogjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë”;
- Vendimin nr. 209, datë 11.10.2019, ka miratuar “Metodologjinë për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatëve jogjyqtarë për në Gjykatën e Lartë”.
- Vendimin nr. 263, datë 21.11.2019, “Për rregullat plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”,
- Vendimin nr.264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”,
- Vendimi Nr. 70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”.

Fillimisht ka nisur procesi për emërimin e gjyqtarëve që vijnë nga radhët e juristëve të spikatur ku për 4 shpallje të bëra publike nga KLGJ për 4 pozicione, i janë pas përfundimit të procesit për 3 pozicione, u propozuan për emërim në mars 2020 pranë Presidentit të Republikës, tre gjyqtarë të përzgjedhur nga radhët e juristëve të spikatur, të cilët vijnë ushtrimin e detyrës pranë Gjykatës së Lartë. Ndërsa me vendimin nr.560, datë 13.11.2020 KLGJ ka kualifikuar edhe kandidatin e katërt jogjyqtar dhe po vijon me procedurat e tjera të përzgjedhjes së tij për emërim si gjyqtar në Gjykatën e Lartë.

Ndërkohë lidhur me promovimin e gjyqtarë në këtë gjykata, KLGJ në dy thirrje të ndryshme ka hapur procedurat për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, në total për **11 (njëmbëdhjetë) pozicione të lira**. Për vendet vakante në Gjykatën e Lartë nga radhët e gjyqtarëve, kanë aplikuar 23 kandidatë, nga të cilët 2 kandidatë janë tërhequr nga kandidimi.

Ngritja në detyrë e gjyqtarëve, në vetvete ka për qëllim garantimin e mirëfunksionimit të sistemit gjyqësor në Shqipëri dhe kufizimi i vendosur në këtë dispozitë synon mbrojtjen e interesit publik për mirëfunksionimin e sistemit gjyqësor në Shqipëri. Këshilli objektivisht është në pamundësi objektive për plotësimin e pozicioneve të lira **brenda tre muajve** nga data e hapjes së procedurave. Ndërkohë, Këshilli ka vlerësuar se hapja e menjëhershme e procedurave për të gjitha pozicionet e lira mbarte disa problematika dhe risqe, të cilat mund të çonin në mosarritjen e objektivit final brenda një kohe optimale. Kështu, Këshilli mbajti parasysh se ngritja në detyrë e gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë, sipas ligjit, do të duhet të kalojë edhe përmes procesit të verifikimit të pasurisë dhe figurës së kandidatëve. Ky proces është përgjegjësi e Këshillit, por marrë shkas nga rrethi i kandidatëve të mundshëm, të cilët që të gjithë janë subjekt rivlerësimi sipas Ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, referuar edhe Vendimit të tij nr.75, datë 23.05.2019, ky proces patjetër që do të interferonte me procesin e rivlerësimit kalimtar të kandidatëve, pra rivlerësimin e tyre me prioritet nga organet e rivlerësimit. Këshilli ka konstatuar ekzistencën e një numri të vogël gjyqtarësh që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar, çka do të thoshte që rrethi i kandidatëve potencialë për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë ka qenë i kufizuar.

Në vijim, Këshilli mbajti parasysh se ngritja në detyrë e gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë, sipas ligjit, është e lidhur edhe me procesin e vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve, sikundër dhe me procesin e renditjes së tyre, procese këto që po zbatohen për herë të parë nga Këshilli, nën një kuadër të ri ligjor, rrethanë kjo e rëndësishme për operativitetin e Këshillit.

Sa më sipër kompleksiteti që ka organizimi i këtij procesi të ngritjes në detyrë, mund të themi se ka përbërë një pengesë për KLGJ në funksionalitetin e kësaj gjykate. Megjithatë, Këshilli siguron se po ndërmerret çdo hap të nevojshëm për të përfunduar sa më parë procesin e plotësimit të Gjykatës së Lartë, duke mbajtur në konsideratë gjithmonë cilësinë e kandidatëve që do përzgjidhen..

- *Në lidhje me pyetjen “A është krijuar Komisioni i Posaçëm për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura? (Pika 1 fq. 12 e udhërrëfyesit)”*

Sa më sipër Këshilli me vendimin nr. 317, datë 19.12.2019, “Për ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për Hartimin e një Plani Veprimesh lidhur me Reduktimin e Çështjeve të Prapambetura dhe Rritjen e Efikasitetit në Gjykatën e Lartë”, të cilit i është zgjatur mandati me vendimin nr. 155, datë 15.05.2020. Objekt i veprimtarisë së këtij Komisioni do të jetë edhe mbikëqyrja dhe zbatimi i Memorandumit të Mirëkuptimit, i nënshkruar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar. Vlen të përmendet gjithashtu se kohët e fundit, Këshilli, me ndihmën e partnerëve ndërkombëtarë dhe në bashkëpunim me Gjykatën e Lartë, ka zhvilluar një Udhëzues për Efikasitetin e Gjykatës së Lartë dhe Reduktimin e Çështjeve të Prapambetura. Ky dokument, i cili parashikon një sërë masash konkrete, të përqendruara kryesisht në ngritjen në detyrë të gjyqtarëve të kualifikuar dhe emërimin e më shumë këshilltarëve ligjorë, synon të adresojë situatën e krijuar në këtë gjykatë për shkak të numrit të lartë të çështjeve në pritje.

- *Në lidhje me pyetjen “Cilat janë rezultatet e ankimit të gjyqtarëve, nëse është bërë një i tillë për përcaktimin e faktorëve nxitës dhe pengues që përkatësisht inkurajojnë gjyqtarët të kandidojnë për ngritje në detyrë në rrethanat aktuale dhe të ardhshme?”*

Lidhur me këtë informacion të kërkuar nga ana juaj sjellim në vëmendje se Këshilli i Lartë Gjyqësor ka përgjegjësinë kushtetuese për mbarëvajtjen e sistemit gjyqësor (neni 147, pika 1, i Kushtetutës), që e zbatuar në realitetin që sistemi gjyqësor gjendet aktualisht do të duhet të konsiderojë jo vetëm bërjen funksionale të Gjykatës së Lartë, por edhe moscenimin e funksionalitetit të gjykatave të tjera nga prej gjyqtarët do të ngrihen në detyrë në këtë gjykatë. Po ashtu, në hapjen e pozicioneve të lira KLGJ ka mbajtur në konsideratë edhe frymën e ligjit, që konsideron ripërtëritjen e përbërjes së Gjykatës së Lartë rast pas rasti dhe jo tërësore të saj, për sa kohë nuk jemi para ngritjes rishtazi të saj. Gjithashtu KLGJ vlerësoi se hapja e menjëhershme e procedurave për të gjitha pozicionet e lira mbart disa problematika dhe risqe, të cilat mund të çojnë në mosarritjen e objektivit final brenda një kohe optimal, konkretisht:

- Në kushtet kur ngritja në detyrë në Gjykatën e Lartë, sipas ligjit, do të duhet të kalojë edhe përmes procesit të verifikimit të pasurisë dhe figurës së kandidatëve, ndërkohë që aktualisht, ka një numër të vogël gjyqtarësh që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar, do të thotë që rrethi i kandidatëve potencial për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë mbetet i kufizuar. Me vijimin e procesit të rivlerësimit, rrethi i kandidatëve potencial të rritet, çka do t’iu jepte kohë dhe mundësi për të kandiduar çdo gjyqtari që aspiron për t’u ngritur në detyrë në Gjykatën e Lartë. Për pasojë do të rriten

mundësitë për përzgjedhjen e kandidatëve cilësorë për promovim në organin më të lartë të pushtetit gjyqësor, çka, përveç se legjitime, është dhe një obligim ligjor për Këshillin;

- Operativiteti i funksionimit të KLGJ në një proces kompleks;
- Hapja në një moment të dytë të procedurës për pozicionet në fushën e të drejtës penale, kur praktikisht të ketë kandidatë potencial të mjaftueshëm për ngritjen në detyrë, si dhe kur organizimi i kësaj procedure të mos sjell implikime të rënda në mbarëvajtjen e sistemit gjyqësor.

Ndërsa në procesin e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë për 11 pozicionet e shpallura kanë kandiduar fillimisht 23 kandidatë, ku më pas 2 prej tyre janë tërhequr nga gara, dy prej kandidatëve kanë pasur kundërshtime të cilat janë të lidhur me rregullimet e nenit 48 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ku përcaktohet se *“kandidati mund të kandidojë për jo më shumë se tre pozicione të lira ose pozicione që priten të bëhen të lira”*. Lidhur me këtë Këshilli ka konsideruar se pika 6, e nenit 48, të Ligjit për Statusin, në mënyrë të qartë kufizon të drejtën e kandidimit për ngritjen në detyrë për më shumë se tre pozicione të lira apo që priten të bëhen të lira, qofshin këto pozicione në të njëjtën gjykatë apo edhe në të njëjtën fushë të së drejtës, deri në përfundimin e procesit. Ndërkohë që të dy kandidatët, kanë mbajtur qëndrimin se ngritja në detyrë në Gjykatën e Lartë është një pozicion pavarësisht numrit të shpalljeve për pozicione të lira të bëra nga KLGJ, ndaj dhe në kushtet kur kanë kandiduar për ngritjen në detyrë në më shumë se tre pozicione të lira, nuk kanë përcaktuar tre pozicionet preferenciale të tyre, për të cilat është disponuar Këshilli sipas ligjit.

Qëndrimin e KLGJ-së për përfshirjen e tyre në vetëm tre procedura dhe mospërfshirjen në procedurat e tjera për të cilat dy kandidatët kishin kandiduar u kundërshtua në rrugë gjyqësore, prej nga ku, tashmë kemi një konsolidim të qëndrimit se ligji kufizon në mënyrë të qartë që *kandidati që kërkon të ngrihet në detyrë nuk mund të aplikojë për më shumë se tre pozicione të lira që janë proces*.

- *Në lidhje me pyetjen “Cilat janë aktet nënligjore që do të krijojnë mundësinë e emërimit të 4 këshilltarëve ligjorë, të diplomuar nga shkolla e Magjistraturës në gusht 2020 sipas pikës II, fq. 7 të Udhërrëfyesit për Funksionalitetin e Gjykatës së Lartë?”*

Sa më sipër KLGJ ka miratuar vendimin nr. 424, datë 12.10.2020, ku janë përcaktuar rregullat më të hollësishme mbi procedurat e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të rekrutimit të kandidatëve për kancelar, për këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë dhe për ndihmës ligjor në gjykatat e apelit, si dhe të pasurisë dhe të figurës së tij.

Menjëherë me miratimin e tij ka filluar procesi i verifikimit të kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë të cilët kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2020, ndërkohë që në mënyrë të përkohshme për to, në muajin nëntor 2020, ka emëruar përkohësisht këto 4 këshilltarë në Njësisë Ligjore pranë Gjykatës së Lartë.

- *Në lidhje me pyetjen “A janë miratuar rregullat standard për procedurat e brendshme të GJL? (pika II, fq. 8 e Udhërrëfyesit)”*

Këshilli me vendimin nr. 643, datë 23.12.2020, miratoi rregullat standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të kategorive të punonjësve të Gjykatës së Lartë. Rregullat standarde për strukturën e Gjykatës së Lartë, përmbajnë norma standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të secilën kategori të punonjësve të Gjykatës së Lartë. Qëllimi i këtyre rregullave është plotësimi i bazës ligjore për organizimin dhe

funksionimin e strukturës së brendshme të Gjykatës së Lartë, për të bërë të mundur funksionimin sa më efektiv, profesional dhe transparent të veprimtarisë së kësaj Gjykate.

Ndërkohë ju bëjmë me dije se rregullat për procedurat e brendshme është në fazë konsultimi.

- *Në lidhje me pyetjen e fundit “A ka nisur hartimi i propozimeve për ndryshimet legjislative në Kode, sipas pikës IV, fq. 11 të udhërrëfyesit?”*

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në cilësinë e organit qeverisës të sistemit gjyqësor, i ngarkuar nga Kushtetuta për të siguruar pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me funksionin ligjor të dhënies së opinionëve mbi legjislacionin, që mund të ndikojnë në punën e gjyqësorit dhe çdo çështje tjetër që është nën përgjegjësinë e tij, ka konsideruar dhe ka kërkuar nga Ministria e Drejtësisë, ushtrimin e nismës për ndryshime ligjore në funksion të adresimit të disa problematikave të lindura gjatë zbatimit të Reformës në Drejtësi. Konkretisht nga KLGJ janë propozuar ndryshime në:

- I. Propozime për shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- II. Propozime për shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar;
- III. Propozime për shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”;
- IV. Propozime për shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.8577, datë 10.02.2020, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Gjithashtu janë dhënë opinione të ndryshme lidhur me nisma për ndryshime në kode dhe ligje të kërkuara nga Ministria e Drejtësisë apo dhe Kuvendi i Shqipërisë.

Ju faleminderit për bashkëpunimin!